

V E N D I M
Nr. 222, datë 4.11.2002

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 7.10.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 184 Akti që i përket:

KËRKUES: AGIM ÇERMA, përfaqësuar nga avokat Fariz Xhurxhi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr. 66, datë 12.5.1998 të Gjykatës së Rrethit Elbasan; nr. 72, datë 29.6.1998 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 233, datë 18.11.1998 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e sipërcituara të gjykatave janë rezultat i zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor dhe për shfuqizimin e tyre si antikushtetues ka parashtruar këto shkaqe kryesore:

Së pari, midis kërkuesit dhe të pandehurve të tjerë ka patur papajtueshmëri interesash. Avokati ka realizuar mbrojtjen njëkohësisht për të pesë të pandehurit. Mbrojtësi del në mbrojtje të Gazmend Çermës (i pranishëm në gjykim), për të cilin kërkon pafajësi dhe në disfavor të kërkuesit Agim Çerma, që kërkon të deklarohet fajtor.

Së dyti, avokati mbrojtës ka tejkaluar tagret e përfaqësimit në këtë proces. Ai nuk ka patur tagre nga i gjykuari Agim Çerma për të pranuar fajësinë e tij, në kuptim të neneve 6 e 50 të Kodit të Procedurës Penale. Pohimi i fajësisë është e drejtë ekskluzive e të pandehurit dhe jo e mbrojtësit.

Për të gjitha veprimet e kryera nga mbrojtësi, kërkuesi pretendon se është shkelur e drejta e tij e mbrojtjes dhe është cenuar procesi ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Elbasan ka deklaruar kërkuesin fajtor në mungesë për veprën penale të parashikuar nga nenet 76 e 25 të Kodit Penal vendim i cili është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës, përse i përket kualifikimit ligjor të veprës, në nenin 78 të Kodit Penal. Ky vendim është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për kërkuesin dhe është ndryshuar për të gjykuarit e tjerë.

Nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i pretendimeve të ngritura nga kërkuesi, duke i analizuar ato me të dhënat që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe me ndikimin e drejtpërdrejtë që ato kanë sjellë në përfundimin e gjyimit, Gjykata Kushtetuese bindet se procesi gjyqësor është cenuar në thelbin e tij. Kërkuesit nuk i është garantuar mbrojtja në procesin gjyqësor. Është shkelur e drejta për t'u mbrojtur me avokat, sepse avokati nuk ka përmbushur në përputhje me ligjin detyrimet e tij ndaj klientit, të cilin

kishte marrë përsipër për ta mbrojtur.

Mbrojtësi në këtë proces gjyqësor ka përfaqësuar njëkohësisht pesë të pandehur të akuzuar për veprën penale të vrasjes, në një kohë që midis të pandehurve rezultoi e vërtetuar dhe e pohuar nga vetë gjykata në vendimin e saj që të ketë patur papajtueshmëri interesash. Neni 54 i Kodit të Procedurës Penale nuk lejon në kushte të tilla realizimin e mbrojtjes ligjore në procesin penal, duke vendosur për të shmangur shkeljen e konstatuar detyrim jo vetëm për mbrojtësin, por edhe për vetë organin procedues.

Mbrojtësi, përpara gjykatës së shkallës së parë, por edhe në të gjithë shkallët e tjera të gjyqimit, ka kërkuar deklarimin fajtor për kërkuesin dhe pafajësinë për të pandehurin tjetër. Edhe në mbrojtjen e paraqitur me shkrim përpara gjykatës së shkallës së parë rezultoi se avokati është mbështetur kryesisht mbi atribimet e të pandehurit tjetër, për të cilin ai ka kërkuar pafajësinë. Njëkohësisht, mbrojtësi në këtë proces gjyqësor ka tejkaluar tagret e tij të përfaqësimit, sepse ka pranuar fajësinë e të gjykuarit Agim Çerma, ndërkohë që sipas nenit 50 të Kodit të Procedurës Penale, kjo është një e drejtë që i rezervohet personalisht të pandehurit.

Nga shqyrtimi i të dhënave që ndodhen në dosjen gjyqësore, rezultoi se avokati mbrojtës pranoi përpara gjykatave për klientin e tij, i cili gjykohej në mungesë se "...këto pohime të të pandehurit Agim Çerma gjejnë vërtetim të plotë me shpjegimet që dha përpara gjykatës i pandehuri Gazmend...", se "...rezultoi e provuar...", se ai "...ka konsumuar plotësisht elementet e veprës penale të vrasjes...", se i pandehuri "...është penduar thellë për veprat penale që ka kryer..." etj.

Veprime të tilla të kryera nga avokati, që prekin të drejtën e të gjykuarit për t'u mbrojtur, janë lejuar nga të gjitha gjykatat që e kanë shqyrtuar këtë çështje. Detyrë e organit procedues, sipas rregullave të përgjithshme procedurale që lidhen me gjykimin, është që t'i krijojë të gjitha mundësitë të akuzuarit për t'u përfaqësuar në mënyrë të efektshme dhe njëkohësisht të sigurohet që avokati të zbatojë detyrat e tij, përndryshe ai duhet të zëvendësohet.

Sipas parimeve të rëndësishme kushtetuese e procedurale dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, në një proces gjyqësor, avokati mbrojtës duhet të veprojë në përputhje me ligjin, standardet dhe etikën e njohur profesionale për të mbrojtur të drejtat e klientit të tij. Kur avokati vepron në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tij në mbrojtje të të drejtave të klientit, ai shkel njëkohësisht edhe të drejtën e individit për t'u mbrojtur me avokat.

Nisur nga qëndrimet e mbajtura nga avokati mbrojtës, të cilat nuk mund t'i përkasin funksionit të mbrojtjes në një proces penal, si dhe duke pasur parasysh se pohime të tilla janë mbajtur parasysh edhe nga gjykata në arsyetimin e vendimit, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkuesit Agim Çerma nuk i është krijuar mundësia për një mbrojtje të ligjshme në procesin gjyqësor, duke iu shkelur në këtë mënyrë e drejta për një mbrojtje të përshtatshme e të efektshme, e cila përbën një cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut, si dhe të jurisprudencës kushtetuese në këtë drejtim.

Shfuqizimi nga Gjykata Kushtetuese i vendimeve gjyqësore si të papajtueshme me Kushtetutën si rrjedhojë e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe dërgimi për shqyrtimin nga fillimi të kësaj çështjeje në gjykatën e shkallës së parë nuk prek afatet e paraburgimit dhe të shqyrtimit të çështjes, pasi sipas kërkesave të nenit 77 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" e të nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale, prishja e vendimeve nga një gjykatë më e lartë i lë ato pa fuqi juridike dhe bën që të fillojnë përsëri afatet e parashikuara për çdo shkallë të procedimit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131 shkronja "f" të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 66, datë 12.5.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 72, datë 29.6.1998 të Gjykatës së

Apelit Durrës dhe nr. 233, datë 18.11.1998 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.